REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2196/3 Prot. Tiranë, më 05.11.2026

VENDIM

Nr. 67 Datë 05.11 2026

"PËR
MIRATIMIN E PAGESËS SË PERSONELIT AKADEMIK ME KONTRATË NGA KATEGORIA "AKADEMIK" DHE NGA KATEGORIA "PROFESOR", NË CILËSINË E PERSONALITETEVE VENDASE OSE TË HUAJA, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS"

Mbështetur në nenin 3, 49, 62 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin nr.57, datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë", në nenin 7, 43, 55 të Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 24, 35 të Rregullores së UST-së, në nenin 20 te Rregullores së FSHL, në Rregulloren e Rekrutimit të Personelit akademik dhe ndihmës akademik të UST-së, Modaliteti D "Personeli Akademik i ftuar", shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes me nr. 2125/1 prot., datë 28.10.2010 "Përcjellje e propozimit për angazhim të personelit akademik të ftuar në Departamentin e Edukimit dhe Shendetit në FSHL për vitin akademik 2026-2027", në Vendimin e Rektoratit nr.130, datë 28.10.2026, në kuadër të bashkëpunimit akademik ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos Itali, në Vendimin e Senatit Akademik Nr. 143 datë 30.10.2026 ""Për miratimin e angazhimit të personelit akademik të ftuar për programin e përbashkët "Master i Shkencave" në "Shkenca Sportive" ndërmjet FSHL-së dhe Universitetit "Carlo Bo" të Urbinos, Itali"". Në Vendimin e BA nr. 30 datë 16.04.2026 "Për një ndryshim të vendimit të Bordit të Administrimit nr 5 datë 13.01.2026, dhe miratimin e marrëveshjes së ndryshuar të programit të përbashkët Master i Shkencave në "Shkenca Sportive", me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes" dhe Universitetit "CARLO BO" të Urbinos në Itali", bazuar në VKM me nr.748, datë 11.6.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar, bazuar në Relacionin e administratorit nr.2213 prot dt 03.11.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 05.11.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pagesave për personelin akademik me kontratë, nga kategoria "Akademik" dhe nga kategoria "Profesor", në cilësinë e personaliteteve vendase ose të huaja, në kuadrin e Programeve të Përbashkëta.

2. Pagesa të realizohet me honorarë për ditë/orë pjesëmarrjeje në procesin e mësimdhënies në UST, ku masa e pagesës të jetë sa 5-fishi i pagesës për orët mbi normë për kategorinë "Profesor".

4. Efektet financiare të përballohen nga të ardhurat dytësore të UST-së.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit të Sporteve të Tiranës, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Njësitë kryesore.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI